



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 251, datë 20.12.2022

**PËR
MIRATIMIN E FONDIT TË PENSIONIT VULLNETAR “SIGAL PRO”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572 datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 9, pika 2, të Ligjit nr. 10197 “Për Fondet e Pensionit Vullnetar” dhe Rregullores nr. 2, datë 13.01.2011 “Për përmbajtjen e kontratës dhe prospektit të fondit të pensionit”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Miratimin e fondit të pensionit vullnetar “Sigal Pro”, nën administrimin e shoqërisë administruese të fondeve të pensionit dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive “Sigal Life Uniqa Group Austria” sh.a.**
- 2. Miratimin e “kontratës tip individuale” të anëtarësimit në fondin e pensionit vullnetar “Sigal Pro”, “kontratës tip të punëmarrësit” për anëtarësim në një plan pensioni të krijuar nga punëdhënësi në fondin e pensionit vullnetar “Sigal Pro”, “kontratës tip të punëdhënësit” për anëtarësim në fondin e pensionit vullnetar “Sigal Pro” si dhe “kontratës tip të punëdhënësit” për anëtarësim në fondin e pensionit vullnetar “Sigal Pro” kur kontribuon së bashku me punëmarrësit e tij.**
- 3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit, për njoftimin e këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Olsi ÇOKU

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Ervin METE